



Prishtinë, 22 shtator 2009

Kodi i ZRRE-së: V\_205\_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

- Nenin 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9 të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 4 dhe 12 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese,
- Aplikacionit për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, të datës 03 mars 2009 të kompanisë Wind Power sh.a, me adresë rruga “Nëna Terezë” kati i I-rë, Lokali 17, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2009 nxori këtë :

## VENDIM

### Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Me të cilin Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se kompania Wind Power sh.a ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) nga era me kapacitet të instaluar prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, KK Fushë Kosovë.
- II Aplikantit Wind Power Sh.A do t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues pas përmbushjes së të gjithë dëshmive të kërkuara sipas Nenin 12 dhe 13 të Rregullit mbi Procedurën e Autorizimit si dhe legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues.
- III. Ky Njoftim nuk nënkupton edhe lëshimin e Autorizimit përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën II.

## Arsyetim

1. ZRrE me datë 03 mars 2009 nga kompania Wind Power sh.a, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 1.35 MW, në lokacionin Golesh, zona kadastrale Harilaq, KK Fushë Kosovë.
2. ZRRE, pas pranimit të dëshmive të fundit origjinale të dërguara nga aplikuesi me datë 17.08.2009, dhe pas vlerësimit të tyre dhe dëshmive të tjera të bashkangjitura aplikacionit të kompanisë Wind Power sh.a, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

3. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen elektronike, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar